



Data: 25.09.19 Ref.: 1780/19D

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), Ligjit për Procedurën e Pergjithshme Administrative (Nr. 05/L0031, datë 25.05.2016), nenit 7 dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ Nr.15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2019, Nr. 08/2019 dhe Nr. 13/2019 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 77-të, të mbajtur më 16.09.2019, mori:

V E N D I M

- I. Riakreditohet Fakulteti i Studimeve Islame në nivel institucional për periudhën tre vjeçare, 1 tetor 2019 – 30 shtator 2022.
- II. Riakreditohen programet e studimit të Fakultetit të Studimeve Islame për periudhën tre vjeçare, 1 tetor 2019 – 30 shtator 2022:
 - Teologji Islame, BA, 240 ECTS, maksimumi 90 studentë për vit akademik
 - Teologji Islame, MA, 60 ECTS, Maksimumi 30 studentë për vit akademik
- III. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m i

I. Fakulteti i Studimeve Islame ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) për riakreditim institucional dhe të programeve të studimit të cekura në dispozitiv të këtij vendimi. AKA ka organizuar dy vizita të ndara me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Fakultetin e Studimeve Islame, me qëllim të vlerësimit në nivelin institucional dhe të programeve të studimit. Vizita e parë është realizuar me 17.07.2019 me ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit me këtë përbërje: Melita Kovacevic dhe Delia Gologan, ndërsa vizita e dytë është realizuar me datë 20.08.2019 me ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit me këtë përbërje: Merdan Günes dhe Delia Gologan.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e mbajtur më 16.09.2019 ka shqyrtuar aplikacionin e Fakultetit të Studimeve Islame dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të dy vizitave, si dhe në rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportet finale të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.


Në lidhje me riakreditimin institucional, raporti i ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit, konstaton se Fakulteti i Studimeve Islame përmbush substancialisht kapitujt e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit. Nga gjithsejtë njëmbëdhjetë (11) kapitujt e standardeve të parapara në Manualin e Akreditimit, ekspertët kanë konstatuar se Fakulteti i Studimeve Islame plotëson substancialisht shtatë (7) (Misioni publik dhe objektivat institucionale; Planifikimi dhe menaxhimi i buxhetit; Burimet dhe Hapësirat; Menaxhimi i Cilësisë; Mësimdhënia dhe Mësimnxënia; Stafi, proceset e punësimit dhe zhvillimi profesional; Bashkëpunimi institucional), ndërsa plotëson pjesërisht katër (4) të tjera (Planifikimi strategjik, qeverisja dhe administrimi; Integriteti akademik, përgjegjësia dhe llogaridhënia publike; Hulumtimi; Administrimi i studentëve dhe shërbimet mbështetëse; Bashkëpunimi institucional).

Sa i përket programeve të studimit të cekura në dispozitiv të këtij vendimi, ekspertët ndërkombëtarë kanë konstatuar se programet e studimit të cekura më sipër përmbushin substancialisht kapitujt e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit dhe rrjedhimisht kanë rekomanduar dhënien e akreditimit.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë sipas Nenit 125 dhe 126 të Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L-031, datë 25 Maj 2016). Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit i cili e ka nxjerrë këtë vendim bazuar në Nenin 128 të LPPA, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas Nenit 127 të LPPA.

Vendimi iu dërgohet:

- Fakulteti i Studimeve Islame
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.


Prof. Dr. Gazmend Luboteni
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë

